



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:188994

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05798775

**C.nr. 996/2017**

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtar Argzon Muçaj, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit XH.K. nga fshati N., Komuna e G. i përfaqësuar nga A.I. sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve P. me seli në Prishtinë, e përfaqësuar sipas autorizimit nga V.V. , lidhur me çështjen e kompensimit të dëmit, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur në prezencë të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa me datë 10.06.2024, përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR** kërkesëpadia e paditësit XH.K. nga fshati N., Komuna e G.

**II. DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve P. me seli në Prishtinë në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 29.03.2017 në fshatin Ll., Komuna e G., paditësit t'ia paguajë shumat si në vijim:

**1.** në emër të dëmit jo material

a) për dhimbje të përjetuara fizike shumë prej .....900.00 euro

b) për frikën e përjetuar shumë prej.....700.00 euro

**2.** në emër të dëmit material

a) në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë në shumë prej.....105.00 euro

b) në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej.....140.00 euro

**III. DETYROHET** e paditura që paditësit, shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë me kamatë ligjore prej 8% në vit, për dëmin jo material do të rrjedh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit me datë 10.06.2024, kurse për dëmin material nga dita e parashtrimit të padisë 18.04.2017, e deri në pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 999.00 euro, e të gjitha në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit ligjor.

**IV. REFUZOHET SI E PABAZUAR** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumave të gjykuara në pikën II të dispozitivit, për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike nga shuma e gjykuar 900.00 euro e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 2,500.00 euro dhe në emër të frikës së përjetuar nga shuma e gjykuar 700.00 euro e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 1,500.00 euro.

### **A r s y e t i m**

Paditësit B.P. dhe XH.K. , në këtë gjykatë me datë 18.04.2017 ka paraqitur padi me kërkesë për shpërblimin e dëmit jo material dhe material, si pasoj e aksidentit i cili ka ndodhur me datë 29.03.2017, në fshatin Ll., Komuna e G., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve P. me seli në Prishtinë dhe B.K.S. me seli në Prishtinë.

Gjykata në seancën përgatitore të datës 21.02.2024 ka konstatuar të tërhequr padinë e paditësit B.P., sipas propozimit të autorizuarit të tij, i cili gjykatës i ka deklaruar se ky paditës përmes ujdisë jashtë gjyqësore e ka realizuar kërkesën e tij. Ndërsa, në seancën e datës 25.05.2024 paditësi XH.K. e ka tërhequr padinë ndaj të paditëses së dytë B.K.S. me çka gjykata përmes aktvendimit në këtë seancë e ka konstatuar të tërhequr padinë në raport me këtë të paditur.

Paditësi përmes padisë, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me datën 29.03.2017 në fshatin Ll. është shkaktuar aksidenti i komunikacionit në të cilin ka pësuar lëndime trupore. Aksidenti është shkaktuar nga ngasësi i automjetit transportues – autobus setra me targa 641 KS 956, i siguruar te e paditura, i cili nga pakujdesia dhe pa u bindur se një veprim i tillë do të rrezikoj pjesëmarrësit në komunikacion ka bërë tejkalim të pasigurt duke kaluar në shiritin e djathtë me ç’rast ka goditur automjetin bujqësor – traktor ferguson, me çka paditësi ka pësuar lëndime trupore. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kërkesëpadia e precizuar duke kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit për dëmin jo material t’ia paguaj paditësit: për dhimbjet fizike shumën prej 2,500.00 euro, për frikën e përjetuar shumën prej 1,500.00 euro dhe në emër të dëmit material për ndihmën e personit të tretë shumën prej 105.00 euro dhe për ushqim të përforcuar shumën prej 140.00 euro, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë për përpilimin e padisë në shumën prej 104.00 euro, për precizimin e lartësisë së kërkesëpadisë në shumën prej 104.00 euro, për taksën gjyqësore në shumën prej 40.00 euro, për ekspertiza mjekësore shumën prej 300.00 euro, për ekspertizë të komunikacionit shumën prej 150.00 euro dhe për tri seanca të mbajtura për secilën nga 135.00 euro në shumën prej 405.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 1,103.00 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nën kërcenim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Pala e paditur, përmes përgjigjes në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se paditësi ka qenë në cilësi të pasagjerit në traktor dhe se traktori është i destinuar për një vozitës e jo edhe për pasagjer, mbi këtë bazë gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi e pa bazuar. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat materiale në shkresat e lëndës,

raportin policor, fotografit e vendit të ngjarjes si dhe ekspertiza e komunikacionit e nxjerr gjatë këtij shqyrtimi kryesor, vlen të ceket fakti se për të paditurën nuk ka qenë kontestuese rrjedha e aksidentit por kërkesa për komenzimin, të cilin po e kërkon paditësi, pasi që i njëjti në momentin e aksidentit ka qenë pasagjer në mjetin transportues i cili sipas Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor konkretisht nenit 182 paragrafi 1 ky mjet ka qenë i destinuar vetëm për një person dhe nuk ka pasur ulëse të montuara, dhe lidhur me këtë edhe neni 193 i këtij ligji i cili ka përcaktuar se në mjete transportuese dhe rimorkio që i tërheq traktori mund të transportohen me se shumti 5 persona të cilët punojnë në ngarkim shkarkim të ngarkesës si dhe kur kryhen pune të tjera bujqësore, pra ligji në mënyrë decisive i ka përcaktuar rrethanat si në rastin konkret, meqenëse paditësi ka qenë i moshës madhore i njëjti edhe përkundër faktit se e ka ditur se me një veprim të tillë e ka të ndaluar të ulet në këtë mjet i njëjti ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi duke e rrezikuar edhe jetën e tij, andaj pretendimet tona janë të bazuara kjo është vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit si dhe deklaratimet në seancë, dhe mbi bazën e të lartë cekurave e paditura e konteston në tërësi bazën juridike të kërkesëpadisë.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Raporti i aksidentit i lëshuar nga Policia e Kosovës i datës 29.03.2017, Fletë lëshimi nga QKUK, Qendra Emergjente në emër të paditësit XH.K. t i datës 29.03.2017, Ekspertiza mjekësore e datës 01.03.2024, Ekspertiza e komunikacionit e datës 17.04.2024 dhe Shiqimi i fotografive nga momenti i aksidentit.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konstatoj se në mes të palëve nuk ishte kontestuese fakti se me datë 29.03.2017 kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit ku lëndime trupore kishte pësuar këtu paditësi, por kontestuese ishte baza e kërkesëpadisë përkatësisht përgjegjësia e të paditurës pasi që e njëjta e konteston kërkesëpadinë e paditësit mbi bazën se i njëjti ka qenë në cilësi të pasagjerit në traktor dhe se traktori është i destinuar për një vozitës e jo edhe për pasagjer.

Nga Raporti i aksidentit i lëshuar nga Policia e Kosovës i datës 29.03.2017, gjykata konstatoj se më datën 29.03.2017 ka ndodhur aksidenti i trafikut, nga i cili aksident ka mbetur i lënduar paditësi XH.K. .

Nga Fletë lëshimi i lëshuar nga QKUK, Qendra Emergjente në emër të paditësit XH.K. i datës 29.03.2017, gjykata konstatoj se paditësi me datë 29.03.2017 ka pranuar shërbime mjekësore në Qendrën Emergjente pranë QKUK-së.

Sipas propozimi të paditësit, për të konstatuar përgjegjësin e të paditurës, gjykata në këtë çështje kontestimore ka nxjerr provën përmes ekspertizës së komunikacionit, të cilën ekspertizë e ka përgatitur eksperti gjyqësor S.B. Përmes ekspertizës, e duke u bazuar në dokumentacionin dhe përshkrimin e bërë nga Policia e Kosovës, dhe atë pozitive përfundimtare, gjurmëve teknike, duke simuluar ngjarjen edhe me programet përkatëse, eksperti ka konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e drejtuesit të autobusit i cili pas tejkalimit të traktorit ka bërë ndërrimin e shiritit nga ana e majtë në të djathtë, dhe ka frenuar me qëllim të zbritjes së udhëtareve, nga ky veprim e ka penguar lëvizjen drejtvizore të traktorit dhe traktori në pamundësi për tu ndalur, me pjesën e përparme e ka goditur autobusin në pjesën e pasme ballore, duke konstatuar se aksidenti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit të autobusit. Tuje, eksperti ka shtuar se, ngasësi i traktorit ka lëvizur në shiritin e tij të komunikacionit, në anën e djathtë, për një moment i është shfaqur pengesa në rrugë (autobusi) dhe nuk ka mundur të parandaloj aksidentin duke konstatuar se ngasësi i traktorit nuk ka kontribuar në këtë aksident. Ndërsa, në seancën e shqyrtimit kryesor eksperti i komunikacionit ka qëndruar prapa ekspertizës së përgatitur dhe njëkohësisht i është përgjigjur pyetjeve të palëve ndërgjyqese, duke shtuar se ngasësi i traktorit nuk ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit, e po ashtu në raport me aksidentin pasagjeri këtu paditësi nuk bartë përgjegjësi.

Me qëllim të konstatimit të shkallës së lëndimeve trupore, e po ashtu për të vlerësuar frikën e paditësit të shkaktuar si pasojë e aksidentit, gjykata sipas propozimit të paditësit, ka nxjerr provat përmes ekspertizave mjekësore dhe atë nga eksperti mjekësor ortoped Dr. F.M. dhe ekspertja mjekësore psikiatër Dr. V.B. Ekspertët mjekësor pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar në shkresat e lëndës, si dhe pas ekzaminimit të paditësit, kanë konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të natyrës së lehtë trupore.

Sipas vlerësimit të eksperteve mjekësor të dhënë përmes ekspertizës mjekësore, në bazë të raporteve mjekësore në shkresa të lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, i realizuar me datë 01.03.2024 në SHSKUK klinika e ortopedisë, leximit, shqyrtimit dhe analizës të dokumentacionit mjekësor të prezantuar në shkresat e lëndës dhe dokumentacionit mjekësor të prezantuar në ditën e ekzaminimit kanë konstatuar se paditësi në momentin e lëndimit dhe pas tij ka pësuar dhimbje fizike dhe atë: me intensitet të rëndë: 24 orë përkundër ordinimit dhe marrjes së terapisë kundër dhimbjeve, dhembje në regjionin e qafës dhe kraharorit dhimbje në qetësi gjatë frymëmarrjes fiziologjike spontane dhe dhimbje të qafës dhe anësisë së sipërme sidomos gjatë lëvizjeve të qafës dhe dorës. Dhimbje me intensitet të mesëm: ka përjetuar për 15 ditë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, dhembje këto më të shprehura në regjionin e qafës dhe kraharorit. Dhembjet kanë qenë të lidhura me aktivitetin fizik gjatë kryerjes së nevojave të përditshme siç është higjiena, veshja, zhveshja, ushqyeshmëria nevojat fiziologjike etj. Dhimbje më me intensitet të ulët: në bazë të anamnezës janë të pranishme akoma kohë pas kohe në regjionin e qafës sidomos gjatë lëvizjeve të sforcuara dhe në ndryshime të kushteve klimatike. Bazuar në këto konstatime, dhe në konstatimin se paditësi nga aksidenti ka pësuar lëndime të lehta trupore, duke marr për bazë edhe natyrën e lëndimeve, gjykata vlerësoj se paditësi në emër të dhimbjeve fizike të shkaktuara si pasojë e aksidentit duhet të kompensohet në lartësi prej 900.00 euro.

Në raport me frikën kanë konstatuar se frika primare: ka zgjatur disa sekonda, e shfaqur në momentin e perceptimit të rrezikut të drejtpërdrejtë për jetën dhe është frikuar për përfundim fatal. Frikë sekondare e intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 24 ore, si gjendje stresi pas traumës, e shfaqur me reagime emocionale, ankth dhe shqetësim të përgjithshëm. Gjate kësaj periudhe i është dhënë ndihma e parë mjekësore, përfshirë terapinë ampulare për qetësim dhe ka vazhduar me realizimin e ekzaminimeve të nevojshme diagnostifikuese. Kjo frikë gradualisht është zbehur dhe ka kaluar në: frikë sekondare e intensitetit të mesëm e cila ka zgjatur për 4 javë, duke u përballur me pasojat shëndetësore të shkaktuara nga ky aksident, përjetimin e herëpashershëm të dhimbjeve trupore në regjionet e atakuara në aksident si qafa dhe kraharori, vështirësi në mbajtjen e imobilizimit- qafores, pa mundësi që në tërësi të realizoj aktivitetet e përditshme jetësore sikurse i ka realizuar para aksidentit. Kjo gjendje e krijuar i ka shkaktuar gjumë jo të rehatshëm, shqetësim, brengosje, rikujtim të ngjarjes traumatike dhe plogështi. Kurse, frikë sekondare e intensitetit të ulur ka vazhduar edhe për një vit, here pas here, sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion dhe në situata të ngjashme me atë të aksidentit, duke e bërë të ndiej shqetësim dhe pasiguri. Bazuar në këto konstatime të ekspertëve mjekësor, gjykata vlerësoj se frika ka qenë evidente në momentin e aksidentit dhe e njëjta ka vazhduar të shfaqet të paditësi. Po ashtu, gjykata vlerësoj lëndimet e paditësit të shkaktuara nga aksidenti, e të cilat nga ekspertiza mjekësore janë konstatuar si lëndime të lehta trupore, bazuar në këtë, dhe në konstatimet e lartcekura të ekspertëve lidhur me frikën e përjetuar nga aksidenti, gjykata vendosi që paditësi në emër të frikës së përjetuar si pasojë e aksidentit duhet të kompensohet në lartësi prej 700.00 euro.

Ndërsa, ekspertet mjekësor kanë vlerësuar se ndihma e personit të tretë: ka qenë e nevojshme për 15 ditë, ndihmë nga anëtarët e familjes e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare siç janë: veshja, zhveshja, higjiena personale, për shkak të dhimbjeve në regjionin e qafës dhe kraharorit ndihmë të cilën paditësi nuk e ka realizuar për shkak të dhimbjeve në regjionin e qafës dhe kraharorit dhe imobilizimit me qafore. Bazuar në këtë konstatim të eksperteve, gjykata vlerësoj se shuma e kërkuar nga paditësi në lartësi prej 105.00-€ është në përputhje me vlerën e cila i takon paditësit në emër të përkujdesjes nga personat e tretë, për çka vendosi që e njëjta të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kurse, sa i përket ushqimit të përforcuar sipas eksperteve mjekësor, i njëjti ka qenë i nevojshëm për 20 ditë ushqim i pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për konsolidimin e indeve të buta. Bazuar në këtë konstatim të eksperteve, gjykata vlerësoj se shuma e kërkuar nga paditësi në lartësi prej 140.00 € është në përputhje me vlerën e cila i takon paditësit në emër të përkujdesjes nga personat e tretë, për çka vendosi që e njëjta të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor, kanë deklaruar se i kanë pranuar ekspertizat mjekësore, dhe për të njëjtat nuk kanë vërejtje e as pyetje apo sqarime për ekspertët, të cilët kanë qenë prezent në këtë seancë. Ndërsa, gjykata të njëjtat ekspertiza i ka pranuar në tërësi si të besueshme, meqë të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, duke ofruar të dhëna të mjaftueshme lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore, andaj të njëjtat i mori për bazë me rastin e vendosjes sipas padisë së paditësit.

Rrjedhimisht, në bazë të gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi në aksidentin e trafikut të datës 29.03.2017, ka qenë në cilësi të pasagjerit në traktor, ku ngasësi i traktorit gjatë lëvizjes në shiritin e tij ka goditur prapa autobusin, sepse paraprakisht ngasësi i autobusit duke vepruar nga pakujdesia ka bërë ndërrimin e shiritave, duke shkaktuar aksidentin, si pasojë e të cilit paditësi ka pësuar lëndime trupore. Në këtë përfundim, gjykata arriti mbi bazën e fakteve vendimtare, dhe atë nga raporti i policisë, përmes të cilit konstatoj se me datën 29.03.2017 ka ndodhur aksidenti i trafikut në të cilin kanë qenë të përfshirë autobusi Setra me numër të regjistrimit 641 KS 956 i siguruar përmes policës së sigurimit tek e paditura, se paditësi po atë ditë e ka vizituar Qendrën Emergjente pranë QKUK-së, fakt që vërtetohet nga Fletëlëshimi i lëshuar nga QKUK, në emër të paditësit XH.K. t i datës 29.03.2017, se paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore nga ky aksident, fakt ky që vërtetohet nga ekspertiza mjekësore e përgatitur ekspertet mjekësor e datës 01.03.2024, se aksidenti është shkaktuar me fajin e ngasësit të autobusit Setra, dhe se paditësi nuk ka kontribuar në këtë aksident, fakt ky që gjykata e vërtetoj nga ekspertiza e komunikacionit.

Në bazë të provave të prezantuara dhe gjendjes faktike të vërtetuar si me lartë, gjykata vlerëson se në këtë çështje juridike kontestuese duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tani e tutje LMD).

Neni 136 paragraf 1 i LMD-së parasheh: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa, në bazë të nenit 140 të LMD-së parashihet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Kurse, me paragrafin 1 të nenit 159 të LMD-së përcaktohet se: *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”*. Në lidhshmëri me këtë, neni 169 paragraf 1 i LMD-së parasheh se: *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”*. Bazuar në këto dispozita, në rastin konkret gjykata vlerësoj se personi i cili ka shkaktuar aksidentin kishte mbulesë të sigurimit për automjetin e tij tek e paditura, dhe bazuar në këtë, për dëmin e shkaktuar si për atë material dhe jo material është e detyruar që këtë t’ia paguaj e paditura, në shumat përkatëse në të holla, me qëllim të shpërblimit të dëmit siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me paragrafin 1 të nenit 183 të LMD-së përcaktohet se: *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*. Bazuar në këtë dispozitë dhe në nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket kompensimit në emër të dhimbjeve fizike në emër të frikës së përjetuar, duke marr parasysh faktin se kompensimi i dëmit jo material konsiderohet si satisfaksion për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Lidhur me pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit, për pjesën e refuzuar, sa i përket dëmit jo material, gjykata vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, duke marr për bazë natyrën e lëndimeve të paditësit dhe frikën e përjetuar, për çka vendosi që e njëjta të refuzohet.

Gjykata i vlerësoj edhe pretendimet e të paditurës, e cila pretendon se sipas Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor mjete motorik në këtë rast traktori është i destinuar vetëm për ngasës e jo për pasagjer, mirëpo në raport me këto pretendime gjykata vlerëson se të njëjtat nuk ndikojnë lidhur me përgjegjësinë e të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga i siguruari i të paditurës. Kjo për faktin se, nëse paditësi ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor, atëherë i njëjti përgjigjet në procedura tjera për veprimet e tij, dhe atë ashtu siç përcaktohet me nenin 195 paragraf 3 të këtij ligji, mirëpo kjo sipas kësaj gjykate në asnjë mënyrë nuk nënkupton që e paditura të lirohet nga përgjegjësia në raport me kompensimin e dëmit, për deri u konstatua sikurse me lartë se aksidenti është shkaktuar me fajin e ngasësit të automjetit i cili ka qenë i siguar tek e paditura dhe rrjedhimisht, e njëjta e bartë përgjegjësinë për kompensimin e dëmit në raport me paditësin.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si me lartë, gjykata arriti në përfundim se e paditura mban përgjegjësi për dëmin që i është shkaktuar palës paditëse nga aksidenti i trafikut, të cilin dëm e paditura është e obliguar të kompensoj mbi bazën e përgjegjësisë, ashtu siç përcaktohet me nenin 136 paragraf 1, nenin 140, nenin 159 paragraf 1, nenin 169 paragraf 1, dhe nenin 183 paragraf 1 të LMD-së.

Vendimin mbi kamatën gjykata e bazoj në nenin 382 të LMD-së, sipas të cilit: *“1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*. Për dëmin jo material gjykata e njohu të drejtën në kamatë nga momenti i përpilimit të aktgjykimit me datë 10.06.2024. Kjo për faktin se pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatën, nga momenti kur ka kuptuar për llojin dhe vëllimin e dëmit të shkaktuar. Ndërsa, për dëmin material, kamatën e njohu nga momenti i paraqitjes së padisë me datë 18.04.2017, duke u bazuar në propozimin e palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bart shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në dispozitat e nenit 449 dhe 452 dhe 463 të LPK-së. Ndërsa, lartësinë e shpenzimeve të procedurës gjykata e bazoj në Tarifën e Odës së Avokatëve, dhe atë për padi 104.00 euro, për tri seanca të mbajtura për secilën veç e veç nga 135.00 €, shuma prej 405.00 euro, për ekspertiza mjekësore shumë 300.00 €, për ekspertizë të komunikacionit shumë prej 150.00 euro, si dhe për taksë gjyqësore shumë prej 40.00 €, gjithsej shumë prej 999.00 euro në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore, ndërsa kërkesën për shpenzime në emër të parashtresës për precizimin e kërkesëpadisë në shumë prej 104.00 euro, të njëjtën gjykata e refuzoj duke u bazuar në nenin 453 paragraf 1 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në nenin 143 paragraf 1 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**C.nr. 996/2017, datë 10.06.2024**

**Gjyqtari**  
Argzon Muçaj

**KESHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.